BREGDETI I ULËT I GJIRIT TË VLORËS

Kozma Leka

Zona e bregdetit të ulët Treporte-Uji i Ftohtë ka një gjatësi 8 km dhe drejtim veri-perëndim, jug-lindje.
Në këtë bregdet hasen mjaft forma gjeomorfologjike bregdetare, si për shembull: Laguna e Nartës, plazhet ranore, baret nënujore, dunat etj.
Me përjashtim të kodrave të Zvërnecit që përbëjnë një ngritje kodrinore me lartësi të pakët, gjithë pjesa tjetër është e formuar nga një plazh ranor. Lidhur me origjinën dhe evolucionin e këtij plazhi, ka mendime që duhen verifikuar. Më bindës paraqitet mendimi që plazhi ranor i Vlorës është formuar nga materialet e ngurta të sjella prej lumit të Vjosë dhe nga ardhja e materiale më molasikeb e Treporteve.
Dëshmi për formimin e plazhit nga depozitimet e Lumit të Vjosës është ekzistenca e dy shtretërve të lumit në Lagunën e Nartës, (Harta e shekullit të XVII), sasia e madhe e depozitimit ranor dhe veçoritë granulometrike të saj.
Ndikimi i materialeve të Treporteve në mbathjen e plazhit të Vlorës (në mungesë të përcaktimit të drejtpërdrejtë të përbërjes dhe të veçorive të origjinës) e konstatojmë në proceset e sotme aktuale të mbathjes së bregdetit Treporte-Porti i Ri.
Ndikimi i proceseve të tjera si, transporti i rërave për mbathjen e plazhit nga era apo fundi detar është aspak ose pak i mundshëm. Duhet theksuar se në bregdetin e ulët konstatojmë territore që pësojnë mbathje dhe gërryerje.
Raporti ndërmjet këtyre proceseve është 1:2.5, pra, edhe në këto territore shfaqet tendencë e përgjithshme që haset në brigjet e ulëta planetare ku mbizotëron gërryerja mbi mbathjen e plazheve. Sigurisht që, kjo dukuri është shpjeguar mjaft mirë qoftë edhe në faktin se territori gjendet në ulje të vazhdueshme dhe se niveli i detit ka një rritje thuajse konstante.
Ndryshimet e vijës bregdetare të ulët të gjirit të Vlorës janë qa të shpeshta saqë mund të vrojtohen direkt edhe nga banorët vendas. Kjo arrihet nëpërmjet krahasimit të objekteve të tilla si, gjerësia e plazheve me objekte të ndryshme statike, si godina etj. Po kështu, duhet theksuar se, në zonën Treporte-Uji i Ftohtë, dallohen disa sektorë:
Sektori i treporteve me gjatësi 1km gjendet me një gërryerje intensive. Megjithëse shtresat paraqitet të vendosura sipas drejtimit meridional, ekzistenca e materialit të butë molasik dhe ekspozimi i madh ndaj valëve të detit të hapur sjell një gërryerje intensive që llogaritet 10-12 cm në vit.
Sektori Porti i Ri – Treporte, që nga viti 1985 gjendet në një mbushje intensive. Me ngritjen e pontilit (gjatësia 150 m) materialet e formuar nga abrazioni detar i kodrave të treporteve, i cili para vitit 1985 shtrihej gjatë gjithë gjatësisë së plazhit, tani depozitimet në sektorin pontil-treporte. Mbushja e fuqishme ka sjellë formimin e një fushe ranore me gjatësi 400-500 m. Kjo vazhdon të zgjerohet duke formuar plazhin ranor më të madh të gjirit të Vlorës.
Sektori ish-kampi i pionierëve- porti i ri, ka gjatësi 5 km dhe gjendet në gërryerje galopante me ritëm 0.8m deri në 3m në vit. Burim tjetër i ushqimit të plazhit mbetet ardhja e rërave nga fundi i detit. Por, thellësia relatifisht e madhe e fundit detar dhe valëzimi i dobët rrjedhimisht në një gjatësi të pakët si pasojë kërkojnë një thellësi të vogël për procesin e vrondullimit dhe njëkohësisht për çvendosjen e rërave të fundit detar.
Sektori, ish-kampi i pionierëve-plazhi i ri, me gjatësi 2km, ka një gërryerje të lehtë dhe paraqet plazhin më të ekuilibruar nga të gjithë sektorët e tjerë.
Zona e Pashalimanit paraqet një plazh origjinal me karakter zallishtor. Ky plazh gjendet nën gërryerje të lehtë dhe të vazhdueshme që nuk i kalon 0.5 m në vit. Pra, e gjithë zona e ulët bregdetare ka një gjatësi rreth 17 km. Ajo përbëhet nga plazhe ranorë dhe gurorë që i janë nënshtruar procesit të gërryerjes në masë (59%) dhe (23%) janë në mbushje ndërsa (17%) në gjendje ekuilibri. Ky raport i proceseve detarë të gjirit të Vlorës, pak ndryshon nga mesatarja botërore (rreth 70% e plazheve gjenden nën procesin e gërryerjes, 10% në mbushjen me materiale, 20% në ekuilibër).
Lagunat përbëjnë forma gjeomorfologjike të rëndësishme. Laguna e Nartës përbën një minierë të vërtetë të kripës. Aty mund të zhvillohet turizmi balnear, shkencor, peshkimi etj. Ndërsa laguna e Pashalimanit lejon zhvillimin e turizmit balnear dhe kultivimin e peshkut.
Njohja e ligjësisë së zhvillimit të formave morfologjike bregdetare dhe ndryshimet sasiore të tyre janë të domosdoshme për ngritjen e objekteve të pushimit dhe infrastrukturave përkatëse. Bregdeti i ulët i gjirit të Vlorës jep garanci për ndërtimet.

Gjatë ndërhyrjes së shoqërisë njerëzore në zonën bregdetare duhet të përqendrojë vëmendjen dhe në mjaft dukuri negative më karakter natyror ose të shkaktuar nga njeriu gjatë veprimtarisë së tij prodhuese.
Efekt negativ për zonën e gjirit të Vlorës paraqet veprimtaria sizmike, ekzistenca e shumë thyerjeve tektonike, rrit shkallën e rrezikshmërisë sizmike, prandaj çdo ndërtim apo investim i vazhdueshëm është e domosdoshme konsultimi me hartën e specialistët e mikrozonimit sozmik. Zona e Vlorës bën pjesë në zonat me intensitet të madh sizmik që llogariten në tetë ballë.
Njohja e proceseve dhe mbathjes së plazheve përbën një nga detyrat themelore të urbanistëve që përcaktojnë sheshet e ndërtimit. Ngritja e porteve, marrja e rërës për ndërtim, pyllëzimi i zonës bregdetare shoqërohen me ndryshimin e morfologjisë së plazheve dhe mund të sjellin pasoja të paparashikuara negative. Njohja e dinamikës së shpateve dhe parashikimi i proceseve ekzogjene të dëmtimit si, rrëshqitjet apo rrëzimet (siç ka ndodhur në zonën e Radhimës) duhet patur në qendër të vëmendjes të specialistëve të ndërtimit të transportit.
Është e domosdoshme, njohja e dukurive negative që ndodhin në atmosferë. Të tilla janë erërat e fuqishme që vijnë nga kuadrati Veri-perëndimor, nga Jugu e Veri-lindja. Ato, përmbajnë vlera mjaft të rëndësishme energjitike që mund të shfrytëzohen.
Ka patur dhe mjaft rastisje të erërave të fuqishme (18-03-1970) era pati një fuqi 40 m/s dhe u shoqërua me dëme në banesa, pemë frutore, ullishte, shkatërrimi i 2.5 ha sera në Llakatund. Më 08-04-1970 u përsërit një erë e fuqishme me fuqi 45 m/s që u shoqërua me dëme të kulturave bujqësore dhe me vdekjen e dy personave.
Ardhja e shirokut në mjaft raste shoqërohet me rritjen e thatësirës dhe të temperaturave të ajrit. Kohëzgjatja e erërave të nxehta dhe ta thata në Vlorë llogaritet rreth 75 orë të vazhdueshme duke sjellë dëme mjaft të mëdha në bujqësi.
Të shumta janë shkarkesat elektrike në zonën e rrëzës së kanalit, Llogara, Malin e Çikës etj.
Duhet theksuar gjithashtu se valëzimi detar në përgjithësi është i vogël dhe efektet katastrofike janë të rralla. Valëzimi me lartësi shumë të vogël 0.25 m dhe të vogël 0.3-0.5 m zë përqindjen më të madhe të rasteve të valëzimit 83.7% në verë dhe 48.6% në dimër. Por duhet theksuar se valëzimi në gjirin e Vlorës paraqitet me lartësi të vogël (rreth 74% e valëzimit ka lartësi 0.25m dhe 0.135 e valëzimit ka lartësi 2-3 m).
Nga ana tjetër kemi paraqitjen selektive të energjisë së valës që vjen nga deti i hapur dhe energjia e valëve në brendësi të gjirit të Vlorës, ku duhet parë efekti i ndryshëm i energjisë së valës në brigjet e larta dhe të ulëta dhe në shkëmbijtë rezistencë dhe jo rezistencë.

Përparësitë e zonës bregdetare Treporte-Orikum

1. Pozita gjeografike e favorshme në lidhje me komunikimin dhe shkëmbimin e mallrave e njerëzve.
2. Gjiri detar më i madh dhe më i thellë i vendit, i mbrojtur nga gadishulli i Karaburunit dhe ishulli i Sazanit, krijon kushte të përshtatshme për lundrimin detar dhe ankorimin e qetë të anijeve.
3. Format e ndryshme gjeomorfologjike detare përcaktojnë dhe shkallët e ndryshme të shfrytëzimit të brigjeve për turizmin, ndërtimin e porteve të vegjël, skafet turistike dhe anijet e peshkimit.
4. Trualli i fortë i gëlqerorëve përbën një avantazh për ndërtimin e objekteve të veçanta apo fshatrave turistike.
5. Kushte klimatike janë të përshtatshme për zhvillimin e bimësisë natyrale e të kultivuar.

Aspekte që duhen patur kujdes gjatë aktivitetit human

Një pjesë e zonës bregdetare (pjesë e ulët bregdetare) dhe zona e lartë me shkëmbinj të butë terrigjen, nuk paraqet siguri për investime të rëndësishme të objekteve me karakter industrial apo ndërtues.
Bregdeti i ulët dallohet për një dinamikë të fuqishme nën influencën e faktorëve natyrorë dhe antropik, praktikisht zona nga kodrat e treporteve deri në Ujin e ftohtë, pëson ndryshime me intensitet të ndryshëm ku mbizotëron gërryerja e brigjeve dhe depozitimet e materialeve. Në të dy rastet duhen llogaritur mirë investimet ndërtimore se mund të bëhen inventable.
Në zonën bregdetare të lartë ku dalin në sipërfaqe shkëmbinjtë e butë flishorë nuk rekomandohen investime ndërtimore, për shkak të rrëshqitjeve dhe rrëzimeve të shumta.
Duhen evituar ndërtimet e rëndësishme në zonat e thyerjeve tektonike, gjatësore dhe tërthore, në të cilat rigjenerohen tërmete me intensitet më të rritur.

Referencat

Materiali është marrë nga tema: Vlerësimi i potenciali gjeografik i gjirit të Vlorës dhe menaxhimi i tij. (MASTER SHKENCOR- AUTORI: KOZMA LEKA- MBROJTUR NË DEPARTAMENTIN E GJEOGRAFISË NË UNIVERSITETIN E TIRANËS)